



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. DPK
Dep. 03-02/1370/18
Nr. Prot. 07-05-2018
Nr. pages 04

DATË/A:	07.05.2018
REFERENC-Ë:	AKK-DPK-DPKI-03-02-1022/18
PËR/ZA/TO:	Komisionin e Kuvendit të Kosovës për Përzgjedhjen e Kandidateve për Gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese
CC:	z.Hilmi Jashari – Avokati i Popullit z.Ismet Krasniqi – Sekretar i Përgjithshëm i Kuvendit të Republikës së Kosovës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Shaip Havolli, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	OPINION lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit

Të nderuar,

Ju lutem gjejeni më poshtë Opinionin e Agjencisë Kundër Korrupsionit [këtu e tutje “AKK”] për rastin me nr.AKK-03-02/1022/18, i cili ka të bëjë më kërkesën e dorëzuar në AKK më datë 03.04.2018, lidhur me pretendimin për konflikt interesi në procesin e përzgjedhjes së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Ju njoftojmë se në kuadër të kompetencave të AKK-së të përcaktuara në dispozitat e Ligjit Nr. 03/1-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe Ligjit Nr.04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik (më tutje Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit), sipas Nenit 19, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5, AKK “bënë këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të eprorëve, të institucioneve eprorë, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave, dhe për çështje të etikës të lidhura me to, si dhe për regjistrimin rast për rast të interesave”.

Adresimi që është bërë në AKK ka të bëjë me situatën në të cilën është hedhë dyshimi për mundësinë e konfliktit të interesit për Anëtarin e Komisionit vlerësues dhe rekomandues, z.Hilmi Jashari, Kryesues i Institucionit të Avokatit të Popullit, me njërin nga kandidatët pjesëmarrës, në marrëdhënie pune në institucionin e njëjtë.

Prandaj, lidhur me këtë rast, konform kompetencave, Agjencia kundër Korrupsionit lëshon këtë:

OPINION

- I. Nuk ka konflikt të interesit faktik për zyrtarin e lartë z.Hilmi Jashari, Anëtari i Komisionit vlerësues dhe rekomandues dhe Avokat i Popullit, me njërin nga kandidatët pjesëmarrës, në marrëdhënie pune në institucionin e njëjtë. Mund të konsiderohet eventualisht si konflikt në dukje i interesit, por jo konflikt faktik;
- II. Për të fuqizuar parandalimin e konflikti të interesit (qoftë ai faktik, rast për rast apo edhe në dukje), në mënyrë efikase dhe të vazhdueshme nëpër Komisione të ndryshme brenda Kuvendit të Kosovës, AKK jep rekomandime.

ARSYETIM

- I. Konstatimi i AKK-së në këtë opinion jepet duke u bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, konkretisht përkufizimit të nocionit të konfliktit të interesit bazuar në Nenin 6, që përcakton se:

“Konflikti i interesit është gjendja e mospajimit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të zyrtarit të lartë, kur ai ka interesa private të drejtpërdrejta ose të tërthorta, personale ose pasurore, të cilat ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në ligjshmërinë, transparencën, objektivitetin dhe paanësinë e tij gjatë ushtrimit të funksionit publik”.

Në kuptim të kësaj, zyrtari i lartë z. Jashari, Kryesues i Institucionit të Avokatit të Popullit, për të cilin pretendohet se ka konflikt interesi me njërin nga kandidatët në procesin e përzgjedhjes së listës së ngushtë të kandidatëve të kualifikuar për Gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, nuk ka interesa private të drejtpërdrejta ose të tërthorta, personale ose pasurore të përcaktuara në Nenin 6; nuk mund të konsiderohet person i afërt sipas Nenit 3, paragrafit 1, nën-paragrafit 1.4; dhe nuk mund të konsiderohet person i besueshëm sipas Nenit 3, paragrafit 1, nën-paragrafit 1.5 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Ndërsa, konflikti në dukje i interesit është gjendja në të cilën interesat private të zyrtarit duken, në pamje ose formë, sikur kanë ndikuar, ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësi të tij zyrtare, por në fakt, ndikimi nuk ka ndodhur, nuk ndodhë ose nuk ka mundësi të ndodhë (provë e bashkangjitur; Deklarimi i Avokatit të Popullit, AKK-Dpk-03-02/1330/18).

Për më tepër, Neni 6, paragrafi 1, i Ligjit Nr.03L-121 për Gjykatën Kushtetuese përcakton se shqyrtimin e kandidatëve për emërim në Gjykatën Kushtetuese e bënë Komisioni i posaçëm për përzgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese sipas detyrës zyrtare (ex officio). Ndërkaq, paragrafi 2, i Nenit 6 të Ligjit Nr.03L-121 për Gjykatën Kushtetuese përcakton se:

2. Komisioni përbëhet nga këta anëtarë:

- 2.1. Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës apo një anëtar i Kuvendit përfaqësues i deleguar i tij/saj;*
- 2.2. Udhëheqësit e secilit grup parlamentar të Kuvendit të Republikës së Kosovës apo anëtarët e Kuvendit përfaqësues të deleguar të tyre;*
- 2.3. Kryetari i Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës;*
- 2.4. Avokati i Popullit;*
- 2.5. Përfaqësuesi i Këshillit Konsultativ për Komunitete;*
- 2.6. Përfaqësuesi i Gjykatës Kushtetuese.*

Zyrtarët e lartë, (në këtë rast Anëtarët e Komisionit vlerësues dhe rekomandues) janë të angazhuar në këtë proces sipas detyrës zyrtare “ex officio”, sepse kjo është përcaktuar në Nenin 6 të Ligjit Nr.03L-121 për Gjykatën Kushtetuese. Zyrtarët në fjalë kanë mundur të kenë konflikt interesi “rast për rast”, por janë treguar të vetëdijshëm për këtë qysh në fillim të procesit dhe për të gjithë anëtarët kanë qenë të njohura të gjitha rrethanat dhe faktet, e në realitet asnjë nga to, nuk e ka penguar zhvillimin e procesit, sepse kanë qenë situata të menaxhueshme (provë e bashkangjitur; Deklarimi i Avokatit të Popullit, AKK-Dpk-03-02/1330/18).

Zyrtarët e lartë publik janë të obliguar sa herë që kanë njohuri të ekzistimit të konfliktit të interesit privat të tyre, ta bëjnë deklarinimin paraprak.

Konflikti i interesi “rast për rast” është i rregulluar në dispozitat ligjore të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Zyrtarët e lartë publik që të parandalojnë konfliktin e interesit “rast për rast” duhet të bazohen në tre paragrafët e nenit 13, si në vijim:

- 1. “Çdo zyrtar i lartë gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vet deklarinimin paraprak, rast për rast, të*

ekzistencës së interesit të tij privat lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti të interesit” .

2. Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtari i lartë, kur kjo kërkohet nga eprori ose nga institucioni mbikëqyrës. Deklarimi si rregull duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi duhet të kërkohet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur.

3. Vetë deklarimi si rregull bëhet me shkrim, kur zyrtari i lartë përfshihet në një vendimmarrje për ndonjë çështje të caktuar.

II.

Duke qenë se Kuvendi i Kosovës, në radhë të parë është organ legjislativ, pastaj në kuadër të tij krijohen shumë Komisione të ndryshme vlerësuese, rekomanduese edhe vendimmarrëse të drejtpërdrejtë, është e kuptueshme se kur zyrtarët e tij janë të angazhuar në ndonjë nga këto Komisione të ndryshme ndonjëherë krijohet përshtypja e asaj që quhet “konflikt në dukje” i interesit, pavarësisht nga afërsia reale me kandidatët apo edhe nga roli vendimmarrës i tyre në ato procese.

Por, për të qenë puna e zyrtarëve të lartë efikase, sa me objektive dhe me kredibilitet të lartë profesional, AKK konform kompetencave të saj të përcaktuara në ligjet përkatëse inkurajon që të krijohen apo forcohen autoritetet përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesit brenda vet institucionit të Kuvendit të Kosovës, të cilat pastaj në bashkëpunim me divizionin e posaçëm brenda AKK, do të bënin që situatat e ndryshme të konfliktit të interesit të parandalohen në burim, akoma pa prodhuar efekte që do të ishin të dëmshme edhe për vet zyrtarët e lartë publik, por edhe për çfarëdo procesi që ata janë të përfshirë.

AKK është e gatshme për të ofruar ndihmë profesionale dhe teknike për këshillimin dhe mbështetjen e çfarëdo nismave ligjore dhe nënligjore të ndërmarra nga institucioni i juaj publik për parandalimin e konfliktit të interesit.

Agjencia kundër Korrupsionit ju falënderon për bashkëpunimin.

Me respekt,